



**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО - UNIVERSITY OF TETOVA

Bul. "Ilinden" p.n. 1200 Tetovë | Tel: +389 44 356 500 | Fax: +389 44 356 222  
e-mail: international@unite.edu.mk | www.unite.edu.mk

## NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se **Buletini nr. 137** i Universitetit të Tetovës është publik dhe i njëjti mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Buletini do të jetë publik duke filluar nga 27.11.2018 deri më 11.12.2018.

Tetovë, 27.11.2018



**KËSHILLIT TË REKTORATIT  
TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

**R E F E R A T**

**PËR ZGJEDHJEN E NJË BASHKËPUNËTORI NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE  
ASISTENT PËR LËNDËT MËSIMORE NË FUSHËN E PEDAGOGJISË NË FAKULTETIN  
PEDAGOGJIK  
TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

Ne bazë të propozim-vendimit të **Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik, të Univesitetit të Tetovës** nr.24-1346/1, të datës 20.11.2018, lidhur me **Konkursin** për zgjedhjen e bashkëpunëtorit në thirrjet mësimore–shkencore asistent për lëndët mësimore në fushën e pedagogjisë në Universitetin e Tetovës, të shpallur në gazetata ditore "Koha" dhe "Nova Makedonija" me datë 19.10.2018, si dhe në Web-faqen e Universitetit **www.unite.edu.mk** me datë 19.10.2018, Këshilli i Rektoratit, në mbledhjen e mbajtur më 21.11.2018 me vendimin nr. 02-5079/1, formoi **Komisionin recenzues** për përgaditjen e raportit për zgjedhjen e një bashkëpunëtorit në thirrjet mësimore–shkencore asistent për lëndët mësimore në fushën e pedagogjisë, në përbërje:

1. Prof. dr. Fadbi Osmani (kryetar), profesor ordinar, Fakulteti Pedagogjik , Universiteti i Tetovës, Tetovë
2. Prof.dr. Buniamin Memedi (anëtar), profesor inordinar, Fakulteti Pedagogjik, Universiteti i Tetovës, Tetovë
3. Prof.dr. Svetlana Gërņarovska (anëtar), profesor inordinar, Fakulteti Pedagogjik, Universiteti i Tetovës, Tetovë

Në konkursin e shpallur u paraqitën këto kandidatë:

1. Mr. Agron Iljazi
2. Mr. Rahime Murtezani
3. Zana Kadrii

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni recenzues e paraqet këtë:

## RAPORT RECENZUES

### I. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE ARSIMIMI I KANDIDATËVE QË KONKURUAN

**1. Kandidati Mr. Agron Iljazi** është i lindur më 26.06.1987 në Tetovë, në Republikën e Maqedonisë. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Tetovë. Në vitin akademik 2006/2007 regjistrohet si student i rregullt në programin studimor; Pedagogji Profesionale në Fakultetin Filozofik pranë Universitetit të Tetovës. Punimin e diplomës me temë: „ *Mësimi i programuar*” e mbrojti në vitin 2011. Në vitin akademik 2014/2015 regjistrohet në studimet postdiplomike në Fakultetin Filozofik, drejtimi: Pedagogji, pranë Universitetit të Tetovës. Punimin e magjistraturës me temë: “**Vlerësimi i niveleve të diturive dhe arritjeve të nxënësit bazuar në taksonominë e B.Blumit**”, ku me sukses e mbrojti me datë **23.04.2017**.

Në vitin akademik 2017/2018, regjistrohet në studimet e doktoraturës në Fakultetin Pedagogjik „Shën Klimenti i Ohrit“, në Shkup.

Duke filluar nga semestri veror, në vitin akademik 2013/2014 e deri më sot, është i angazhuar si asistent (part-time) në Fakultetin Filozofik (sot Fakulteti Pedagogjik) pranë Universitetit të Tetovës, në kaudër të programit studimor të pedagogjisë.

Përveç arsimimit formal, kandidati Mr. Agron Iljazi ka marrë pjesë në trajnime shtesë, edhe ate:

- » Në vitin 2012, ka ndjekur kurse të organizuara nga Enti për punësim në Tetovë, për përdorim të: Exel, Word, PowerPoint, dhe gjithashtu kurse të gjuhës angleze.
- » Më vitin 2018, kreu kursin e Gj. Angleze, dhe mori çertifikatën e nivelit C1, nga shkolla e gjuhëve “Deutsch” në Tetovë.

## II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Në kuadër të veprimtarisë mësimore-arsimore, Mr. Agron Iljazi aktivisht është përfshirë në mbajtjen e ushtrimeve në studimet deridiplomike, në programet studimore pedagogji profesionale dhe mësimin klasor.

Duke nisur nga viti akademik 2013/2014 e deri më sot kandidati Mr. Agron Iljazi ka mbajtur ushtrimet në lëndët: Didaktika I, Didaktika II, Dokimologji, Pedagogji familjare, Sistemet arsimore II, Pedagogji parashkollore II, Metodika e punës edukative, Didaktika e punës me nxënës të talentuar, Teknikat e hulumtimit pedagogjik, Teknologjia e arsimit.

Përpos kësaj, kandidati Mr. Agron Iljazi më mënyrë aktive është angazhuar si ndihmës teknik, në përgaditjen e Platformës programore për zgjedhjen e dekanit të Fakultetit Pedagogjik për mandatin 2017-2021, Raportin vjetorë për punë të Fakultetit Pedagogjik të vitit akademik 2017/2018, si dhe programën vjetore për punë të Fakultetit Pedagogjik për vitin akademik 2018/2019.

## III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Kandidati Mr. Agron Iljazi është aktiv edhe në veprimtarinë shkencore-hulumtuese, në kuadër të të cilave i ka publikuar edhe këto punime shkencore.

- » Agron Iljazi, *Shkolla si pjesëmarrëse e paqes në rajon*, Philosophica, Vol.2, No. 3-4/ ISSN-1857-9272 (Print), Tetovë 2015, pp.1-565, Pg: 216
- » Mr. Agron Iljazi, Mr. Besjana Rexhepi, “ Fazorizimet e nxënësve, dëshmi e vështërsisë së integritimit në arsimin multikulturor”, Philosophica, Vol4, No. 7, ISSN 1857-9272 (Print), Tetovë 2017, PP.1-134. pg: 25
- » Mr. Besjana Rexhepi, Mr. Agron Iljazi, “Edukimi mediatik, sfidë për demokracinë në shkollat e arsimit bashkëkohor”, Philosophica, Vol.4, No. 7, ISSN 1857-9272 (Print), Tetovë 2017, PP.1-134. pg: 37

- » Mr. Agron Iljazi, Mr. Besjana Rexhepi, “ Roli i metodave dhe teknikave bashkëkohore në përsosjen e mësimdhënësve, Philosophica, Vol. 4, No. 8, ISSN 1857-9272 (Print), Tetovë 2017, PP.1-156, pg: 15

Në mes tjerash është edhe antar i sekretariatit të konferencës shkencore ndërkombëtare, me temë:” Teoria dhe praktika pedagogjike në kohën e ndryshimeve”

**2. Kandidatja Rahime Murtezani**, e lindur me datë 18.03.1992 në fsh. Veshallë, Komuna e Tetovës, Republika e Maqedonisë. Shkollimin e mesëm- gjimnazin e kreu në Tetovë në vitin 2011, ndërsa ka diplomuar në Fakultetin e Administratës Publike dhe Shkencave politike në Universitetin e Europës Juglindore, dhe mori titullin, e Diplomuar në Administrim public, me gjithësejt 180 ECTS kredi.

Në vitin 2015 kandidatja regjistrohet në studimet master, të cilat me sukses i mbaron me 15.05.2018, me gjithësejt 120 ECTS kredi. Krahas arsimit formal, kandidatja ka ndjek edhe trajnime plotësuese dhe kurse kompjuterike, si dhe kurse për gjuhët.

Kandidatja Mr. Rahime Murtezani nuk i plotëson kushtet e parapara konform dispozitave ligjore nga neni 170, alinea 2 nga Ligji për arsim të lartë.

Kandidatja Mr. Rahime Murtezani nuk ka sjellë dhe nuk posedon list të punimeve nga revistat e brendëshme si dhe nga ato ndërkombëtare, në formë të kopjeve.

**3.Kandidatja Zana Kadrii**, e lindur me datë 09.10.1995, në fsh. Strimnicë, Komuna e Zhelinës. Shkollën e mesme të mjeksisë e kreu në Tetovë, ndërsa në vitin akademik 2013/2014 regjistrohet në Fakultetin Filozofik-Programi studimor: Edukim special dhe rehabilitim. Diplomoi me 29.03.2018, dhe ka marrë thirrjen profesionale Edukator special dhe rehabilitues.

Kandidatja Kana Kadrii, nuk i plotëson kushtet e parapara konform dispozitave ligjore nga Neni 170, alinea 1 dhe 2, nga Ligji për arsim të lartë.

Kandidatja në fjalë, nuk ka dorzuar list të punimeve nga revistat e brendëshme, si dhe nga ato ndërkombëtare, në formë të kopjeve.

## PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI

Në kuadër të vlerësimeve pozitive të propozuara në këtë raport, komisioni recenzues konstaton që kandidati **Mr. Agron Iljazi**, i plotëson të gjitha kriteriumet shkencore dhe profesionale për zgjedhjen mësimore-shkencore në thirrjen **asistent për lëndët mësimore në fushën e pedagogjisë**.

Komisioni recenzues, ka nderin dhe kënaqësinë që Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, t'i propozojë që ta miratojë raportin recenzues, dhe të veprojë në përputhshmëri me normat ligjore të Universitetit.

**Tetovë, 23.11.2018**

### KOMISIONI RECENZUES:

**1. Prof.dr. Fadbi Osmani (kryetar)**

---

**2. Prof.dr. Buniamin Memedi (anëtar)**

---

**3. Prof.dr. Svetlana Gërçarovska (anëtar)**

---

**S H T O J C Ë**  
**PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJE TË THIRRJES**  
**BASHKËPUNËTOR**

**Kandidati: Mr. Agron Iljazi**

**Institucioni:** Universiteti i Tetovës, Fakulteti Pedagogjik

**Lëmia shkencore:** Pedagogji

**I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE**

<b>Nr. rendor</b>	<b>Emri i aktivitetit:</b>	<b>Fondi i orëve</b>	<b>Semestra</b>	<b>Pikët:</b>
<b>1.</b>	<b>MBAJTJA E USHTRIMEVE (Lëndët në ciklin e parë të studimeve)</b>	<b>Fondi I orëve</b>	<b>Semestra</b>	<b>Pikët:</b>
				<b>20.7</b>
<b>1.1</b>	<b>Didaktika I (pedagogji profesionale)</b>	<b>0+2</b>	<b>2</b>	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
<b>1.2</b>	<b>Didaktika I (mësimi klasor)</b>	<b>0+2</b>	<b>2</b>	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
<b>1.3</b>	<b>Didaktika I ( drejtimi parashkollor)</b>	<b>0+2</b>	<b>2</b>	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
<b>1.4</b>	<b>Didaktika II (pedagogji profesionale)</b>	<b>0+2</b>	<b>2</b>	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
<b>1.5</b>	<b>Didaktika II (mësimi klasor)</b>	<b>0+2</b>	<b>2</b>	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
<b>1.6</b>	<b>Dokimologji (Pedagogji profesional)</b>	<b>0+2</b>	<b>2</b>	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
<b>1.7</b>	<b>Dokimologji (Mësimi Klasor)</b>	<b>0+1</b>	<b>1</b>	$1 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.45$
<b>1.8</b>	<b>Sistemet arsimore I</b>	<b>0+2</b>	<b>1</b>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
<b>1.9</b>	<b>Sistemet arsimore II</b>	<b>0+2</b>	<b>1</b>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
<b>1.10</b>	<b>Pedagogji parashkollorë II (Pedagogji profesionale)</b>	<b>0+2</b>	<b>1</b>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
<b>1.11</b>	<b>Metodika e punës edukative (profesional)</b>	<b>0+1</b>	<b>2</b>	$1 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 0.9$
<b>1.12</b>	<b>Metodika e punës edukative (mësimi klasor)</b>	<b>0+2</b>	<b>2</b>	$2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$
<b>1.13</b>	<b>Metodika e punës me nx. Të talentuar</b>	<b>0+1</b>	<b>1</b>	$1 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.45$
<b>1.14</b>	<b>Pedagogjia Familjare</b>	<b>0+1</b>	<b>1</b>	$1 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.45$
<b>1.15</b>	<b>Teknikat e hulumtimit pedagogjik</b>	<b>0+1</b>	<b>1</b>	$1 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.45$

<b>1.16</b>	<b>Teknologjia e arsimit</b>	0+2	<b>1</b>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
<b>1.17</b>	<b>Tendencat bashkëkohore në arsim</b>	0+1	<b>2</b>	$1 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 0.9$
<b>1.18</b>	<b>Fëmija hulumtues i natyrës I (drejtimi parashkollor)</b>	0+2	<b>1</b>	$2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$
<b>2.</b>	<b>KONSULTIME ME STUDENTË</b>		<b>Semestra</b>	<b>Pikët:</b>
				<b>1.75</b>
<b>2.1.</b>	<b>Didaktika I (profesional)</b>		<b>2</b>	$30 \times 2 \times 0.002 = 0.12$
<b>2.2</b>	<b>Didaktika I (klasor)</b>		<b>2</b>	$100 \times 2 \times 0.002 = 0.4$
<b>2.3</b>	<b>Didaktika I (parashkollor)</b>		<b>2</b>	$5 \times 2 \times 0.002 = 0.02$
<b>2.4</b>	<b>Didaktika II (profesional)</b>		<b>2</b>	$30 \times 2 \times 0.002 = 0.12$
<b>2.5</b>	<b>Didaktika II (klasor)</b>		<b>2</b>	$100 \times 2 \times 0.002 = 0.4$
<b>2.6</b>	<b>Dokimologji (profesional)</b>		<b>2</b>	$30 \times 2 \times 0.002 = 0.36$
<b>2.7</b>	<b>Dokimologji (klasor)</b>		<b>1</b>	$100 \times 1 \times 0.002 = 0.2$
<b>2.8</b>	<b>Fëmija hulumtues I natyrës I (parashkollor)</b>		<b>1</b>	$5 \times 1 \times 0.002 = 0.01$
<b>2.9</b>	<b>Sistemet arsimore II</b>		<b>1</b>	$30 \times 1 \times 0.002 = 0.06$
<b>2.10</b>	<b>Teknologjia e arsimit</b>		<b>1</b>	$30 \times 1 \times 0.002 = 0.06$
<b>3.</b>	<b>Anëtare e komisionit për vlerësim ose mbrojtje të punimit të diplomës</b>			<b>Pikët:</b>
				<b>0.2</b>
<b>3.1.</b>	<b>Anëtare e komisionit për vlerësim ose mbrojtje të punimit të diplomës</b>			$1 \times 0.2 = 0.2$

## II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE



Nr. Rend.	Emri I aktivitetit:	Pikët:
<b>1.</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar</b>	<b>18.1</b>
1.1.	Agron Iljazi, <i>Shkolla si pjesëmarrëse e paqes në rajon</i> , Pholosophica, Vol.2, No. 3-4/ ISSN-1857-9272 (Print), Tetovë 2015, pp.1-565, Pg: 216	3
1.2.	Mr. Agron Iljazi, Mr. Besjana Rexhepi, “ Fazorizimet e nxënësve, dëshmi e vështërsisë së integritimit në arsimin multikulturor”, Pholosophica, Vol4, No. 7, ISSN 1857-9272 (Print), Tetovë 2017, PP.1-134. Pg: 25	3x0.9=2.7
1.3	Mr. Besjana Rexhepi, Mr. Agron Iljazi, “Edukimi mediatik, sfidë për demokracinë në shkollat e arsimit bashkëkohor”, Pholosophica, Vol.4, No. 7, ISSN 1857-9272 (Print), Tetovë 2017, PP.1-134. Pg: 37	3x0.9=2.7
1.4	Mr. Agron Iljazi, Mr. Besjana Rexhepi, “ Roli i metodave dhe teknikave bashkëkohore në përsosjen e mësimdhënësve, Pholosophica, Vol. 4, No. 8, ISSN 1857-9272 (Print), Tetovë 2017, PP.1-156, pg: 15	3x0.9=2.7
<b>2.</b>	<b>Abstrakte të publikuara në librin e abstrakteve nga Konferencat Shkencore Kombëtare/Ndërkombëtare</b>	<b>3</b>
2.1.	Agron Iljazi, <i>Shkolla si pjesëmarrëse e paqes në rajon</i> ,Konferenca e dytë ndërkombëtare shkencore e Fakultetit Filozofik pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës – SICPHF 2014, me temë: „BALLAFAQIMI ME TË KALUARËN DHE RIMENDIMI I PAQËS NË BALLKANIN MULTIKULTUROR“, Universiteti Shtetëror I Tetovës, Fakulteti Filozofik & ZFD Forum, Tetovë, 17-18 Tetor 2014	<b>1</b>
2.2.	Mr. Agron Iljazi, Mr. Besjana Rexhepi, “ Fazorizimet e nxënësve, dëshmi e vështërsisë së integritimit në arsimin multikulturor”, Konferenca e katërt ndërkombëtare shkencore „ARSIMI DHE EDUKIMI NË SHOQËRITË ME DIVERSITET KULTUROR“, organizuar nga Fakulteti Filozofik – UT & Universiteti „Kadri Zeka“- Gjilan, Tetovë, 28-29 tetor 2016	<b>1</b>
2.3.	Mr. Besjana Rexhepi, Mr. Agron Iljazi, “Edukimi mediatik, sfidë për demokracinë në shkollat e arsimit bashkëkohor”, Konferenca e katërt ndërkombëtare shkencore „ARSIMI DHE EDUKIMI NË SHOQËRITË ME DIVERSITET KULTUROR“, organizuar nga Fakulteti Filozofik – UT & Universiteti „Kadri Zeka“- Gjilan, Tetovë, 28-29 tetor 2016	<b>1</b>
<b>3.</b>	Pjesëmarrje në tubim shkencor/profesional me referat	<b>4</b>
3.1.	Konferenca shkencore ndërkombëtare „ “, 2 <sup>nd</sup> International Conference of the Philosophic Faculty – SICPHF 2014: „FACING THE PAST AND RETHINKING PEACE IN THE MULTICULTURAL BALKAN“, Tetovo, 17-18 okтомври 2014	<b>2</b>

	Prezantim oral	
<b>3.2.</b>	Konferenca shkencore ndërkombëtare „EDUCATION IN SOCIETIES WITH CULTURAL DIVERSITY“, 28-29 Октомври 2016 “ Prezantim oral	<b>2</b>

### III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

<b>Nr. rend.</b>	<b>Emri i aktivitetit:</b>	<b>2</b>
<b>1.</b>	<b>Pjesëmarje në aktivitete promovuese të fakultetit/institutit</b>	
<b>1.1.</b>	Pjesëmarje në Javën e veçantë studimore të organizuar nga fondacioni "Arsimi Bildung Education" nga Zvicra, realizuar në periudhën 06.03.2017-10.03.2017	<b>1</b>
<b>2.</b>	Antar i këshillit organizativ të tubimit shkencor/profesional	
<b>2.1.</b>	Konferenca Ndërkombëtare/Shkencore e Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës, me temë: “ Teoria dhe praktika pedagogjike në kohën e ndryshimeve”	<b>1</b>

<b>Nr. rendor</b>	<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE</b>	<b>Pikët:</b>
<b>I.</b>	<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>22.47</b>

<b>II.</b>	<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>18.1</b>
<b>III.</b>	<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE</b>	<b>2</b>
	<b><i>Gjithsej:</i></b>	<b>42.57</b>

**KOMISIONI RECENZUES:**

**1. Prof.dr. Fadbi Osmani (kryetar)**

---

**2. Prof.dr. Buniamin Memedi (anëtar)**

---

**3. Prof.dr. Svetlana Gërçarovska (anëtar)**

---